



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4701 Prot.

Roskovec, më 02.07 2021

VENDIM
NR. 42 DATË 30 . 06 . 2021

“PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.88 DATË 02.12.2020 “PËR MIRATIMIN E
PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2021”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 54 gërma f , të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35,pika 1 dhe 2,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

Referuar paketës fiskale të vitit 2021 miratohet shtesë në kreu II, nënkategoria II.1 dhe II.3 si më poshtë:

1. Për subjektet të cilet nuk kanë seli në bashkinë Roskovec por që ushtrojnë aktivitetet të shitjes së ujit të pijshëm me autobotë, të aplikojmë tarifatat si më poshtë :
 - a. Tarifë regjistrimi pranë Drejtorisë së të ardhurave vendore 12,000 lekë për persona fizik dhe 15,000 lekë për persona juridik.Kjo tarifë paguhet në momentin që regjistrohet subjekti.
 - b. Tarifë pastrimi – 12.000 lekë/çdo autobotë
 - c. Tarifë Parkimi – 4.500lekë/çdo autobotë

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për pagesën e tarifës së pastrimit dhe parkimit do të jetë vjetore dhe i menjëherëshëm,30 ditë pas marrjes së njoftimit detyrimit. Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të numrit të autobotëve që ka cdo subjekt që ushtron aktivitetet të shitjes së ujit të pijshëm.

2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore, për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 5

